



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

FTESË PËR NEGOCIATË

Lënda: “Për prodhimin e një spoti publicitar informues/ndërgjegjësues mbi mbrojtjen e fëmijëve në internet”.

Drejtuar: Organeve të Masmedias/Agjensive të Specializuara

Të nderuar,

Mbështetur në ligjin nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1195, datë 26.11.2008, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve apo të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi nga organet e Administratës Shtetërore”, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ju dërgon këtë ftesë për negociatë për realizimin dhe prodhimin e një spoti publicitar informues/ndërgjegjësues mbi mbrojtjen e fëmijëve në internet.

Qëllimi: Fëmijët përbëjnë një nga grupet më të ndjeshme në mjedisin digjital dhe janë veçanërisht të ekspozuar ndaj rreziqeve kibernetike. Ky spot synon ndërgjegjësimin e prindërve dhe kujdestarëve përmes një mesazhi të qartë, edukativ dhe mbështetës mbi mekanizmat e mbrojtjes dhe kontrollit prindëror ndaj kërcënimeve *online*.

Kërkojmë të na vini në dispozicion ofertën tuaj për shërbimin e kërkuar, sipas specifikimeve teknike për prodhimin e spotit informues;

1. Prodhimin e një spoti informues / ndërgjegjësues mbi mbrojtjen e fëmijëve në internet;
2. Përgatitja e konceptit krijues dhe skenarit të spotit sipas qëllimit të mësipërm;
3. Kohëzgjatja e spotit të jetë jo më pak se 25 sekonda;
4. Transmetimin e spotit në 3 media audiovizive kombëtare përfshirë TV publik;
5. Spoti të transmetohet në intervalet më të ndjekura të pasdites dhe mbrëmjes në harkun kohor 10 ditor;
6. Spoti të shoqërohet me elemente grafike dhe titra;
7. Mesazhi duhet të jetë i qartë;
8. Përdorimi i muzikës të jetë në përputhje me legjislacionin mbi të drejtat e autorit;
9. Spoti duhet të përmbajë logon e Autoritetit për Sigurinë Kibernetike;
10. Përfshirja e adresës zyrtare për informim: info@aksk.gov.al.

Fondi limit në dispozicion për ofrimin e prodhimit dhe shërbimit të mësipërm do të jetë: 1,624,850 (një milion e gjashtëqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Afati i fundit për paraqitjen e ofertave, pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në zyrën e Protokollit, nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara, është data 01.09.2025 ora 15:00. Paraqitja e ofertës pas këtij orari nuk do të pranohet.

Organi i masmedias/Agjencia e specializuar që do të paraqesë konfirmimin për vazhdimësinë e negociatave, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

Kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit

1. Subjekti të jetë i regjistruar pranë administratës tatimore me status aktiv;
2. Të ketë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2024;
3. Të mos jetë në proces falimentimi;
4. Të mos ketë detyrime tatimore të papaguara përfshirë detyrime të sigurimeve shëndetësore & shoqërore;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;
6. Të mos jetë i dënuar për shkelje penale;
7. Fusha e veprimtarisë të jetë në përputhje me kërkesat e paraqitura në këtë “Ftesë për negociatë”;
8. Subjekti duhet të provojë realizimin e shërbimeve të së njëjtës natyrë përmes faturave tatimore të lëshuara në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi
9. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuar të energjisë elektrike, të kontratave të energjisë që ka subjekti, që është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e subjektit, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.

Kriteret e veçanta të kualifikimit

1. Të plotësojë formularin e ofertës ekonomike;
2. Të përcaktojë qartë listën e çmimeve të shërbimeve ;
3. Të dorëzojë vërtetim i xhiros vjetore për vitin 2024;
4. Të dorëzojë vërtetim nga banka për numrin e llogarisë bankare dhe IBAN;
5. Të dorëzojë kontrata të ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit (kontrata ose referencë);
6. Të dorëzojë deklaratën që i përmbush specifikimet dhe termat e referencës;
7. Të dorëzojë deklaratë që transmetimi do të kryhet në media të cilat janë aktive dhe të licencuara sipas legjislacionit në fuqi;
8. Të dorëzojë projekt-ide ose propozim krijues i spotit.

Kriteret e Vlerësimit

- Vlerësohet me 35 pikë oferta më e ulët ekonomike;
- Vlerësohet me 20 pikë koha televizive për transmetim;
- Vlerësohet me 35 pikë projekt-idea ose propozimi krijues i spotit;
- Vlerësohet me 10 pikë eksperiencia të mëparshme.

Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme përbën kusht për skualifikimin e ofertuesit. Dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kriterëve, të siguruar jo më parë se 3 muaj nga dita e hapjes së ofertës, duhet të paraqiten origjinale ose kopje të njehsuara me to.

Ofertat për vazhdimësinë e negociatave:

Ofertat duhet të vijnë të gjitha në një ditë të vetme, të mbyllura në zarf jo transparent, të firmosur, vulosur, me emrin dhe adresën e subjektit negociues, me shënimin “Mos e hapni, me përjashtim të rastit kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës 01.09.2025 ora 15:00. Ato duhet të dorëzohen nga përfaqësuesit e organeve të medias/ agjensive të specializuara, pranë zyrës së protokollit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, brenda orës 15:00 në datën e përcaktuar 01.09.2025. Në të kundërt ato do të refuzohen dhe nuk do të merren për shqyrtim. Oferta ekonomike duhet të jetë e paraqitur në monedhën Lekë pa TVSH dhe me TVSH e përcaktuar në një zë të veçantë në ofertë.

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:

Emri: Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike
Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati 1, Tiranë;
Faqe web: www.aksk.gov.al E-mail info@aksk.gov.al

Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr. 1195, datë 05.08.2008.

Mbetemi në pritje të ofertave tuaja,

Ju falënderojmë për bashkëpunimin!